

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”

I. HYRJJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për Universitetin “Eqrem Çabej”. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”(LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës UGJ ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. UGJ-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së UGJ-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.uogj.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e UGJ-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj. Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së UGJ -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave. UGJ-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e UGJ-së dhe përkatësisht: Ligji 80/20015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, “Kodi i Punës i R.SH” i ndryshuar, ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ligji 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ligji nr.9049 datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ligji nr.8480 datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe të akteve nënligjore (VKM, Udhëzime, etj), Statuti i UGJ, Rregullore e UGJ e miratuar nga Senati Akademik i UGJ, Kodi i Etikës i UGJ; Rregullore e Brendshme e Punës e miratuar etj.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Universiteti “Eqrem Çabej” vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit eëë.uogj.edu.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore dhe

subvencionimin e studentëve të shkëlqyer, të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të UGJ-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- UGJ-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga UGJ-ja. Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS UGJ

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtj	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Ugj është ent publik i arsimit të lartë i cili ka për funksion dhe qëllim zhvillimin e arsimit të lartë pas atij tëmesëm dhe kualifikimin dhe dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademikë. Ai është i ndarë në strukturën	Neni 7/1/a/d i ligjit nr.119/2014; Neni 18, 22 e në vazhdim i ligjit, 80/2015.	www.uogj.edu.al	Pas miratimit të strukturës nga Bordi i Administrimit.	Vendosur në faqen zyrtare	Bordi i Administrimit/ Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademiqe-Administrative

<p>Ligji nr.8834 datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit“; ligji nr.9840 datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të</p>	<p>Neni 7/1/b i ligjit nr.119/2014</p>	<p>www.uogj.edu.al</p>	<p>Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi ose ardhja në formë zyrtare e një akti ligjor ose nënligjor në fushën e arsimit të lartë.</p>	<p>Vendosur në faqen zyrtare</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative</p>
<p>Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.</p>	<p>Neni 7/1/c/g</p>	<p>Kërkesat për informim bëhen sipas formatit tip që gjendet në eëë.uogj.edu.al dhe drejtohen në adresën postare: Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokaster. Lagjia 18 Shtatori, Rruga Studenti, Gjirokastër</p>	<p>Pas miratimit të Programit të Transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh</p>	<p>Vendosur në faqen zyrtare</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative</p>

Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	Neni 7/1/c/g	Orari zyrtar 8:00 deri në 16:00, hënë deri të premten Adresa: Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokaster. Lagjia 18 Shtatori, Rruga Studenti, Gjiroakstër	Pas miratimit të Programit të Transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh.	Vendosur në faqen zyrtare	Zyra e Marrëdhënieve me Publikun
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e në punë	Neni 7/1/d; Neni 36-56 të ligjit 80/2015; Statuti i Ugj	Në Ligjin 80/2015, në Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" si dhe të vendosura në faqen zyrtare të	Sa herë ka shpallje	Vendosur në faqen zyrtare	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni7/1/dh të ligjit nr.119/2014, Neni 7/e/ë/, neni 116 të ligjit 80/2015;	Raporte të auditimit të kryera në njësitë vartëse	Menjëherë pas miratimit të raporteve përkatëse ose depozitimit të tyre pranë UGJ	Vendosur në faqen zyrtare	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative

Buxheti	Neni 7/1/e të ligjit nr.119/2014, Neni 38/h/, neni 49/c/ të ligjit nr. 80/2015, ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin finciar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr.9936 datë 26.6.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor”	Tabela buxheti për shpenzime korrente e investime. Në zbatim të VKM 781, datë 26.12.2018 pranë Qendrës Institucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar. ëëë.rash.al	Nga hyrja në fuqi e akteve ligjore te ndryshimit ose ato nenligjore. Menjehërë pas miratimit nga Bordi i Administrimit Ugj. Çdo 3 mujor Dokumentet financiare me kërkesë	Vendosur në faqen zyrtare	Drejtoria e Shërbimeve Universitare.
Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë të ligjit nr.119/2014, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”	Regjistri i prokurimeve; Regjistri i realizimit të kontratave	Menjehërë pas miratimit në APP. Cdo 3 mujor	Vendosur në faqen zyrtare	Zyra e Prokurimeve Publike.
Shërbimet e autoritetit për publikun	Neni 7/1/f të ligjit nr.119/2014, nenet 69-82 të ligjit 80/2015; Bursa për studentë te shkëlqyer sipas nenit 11/1/b/, nenit 85/1 të ligjit 80/2015; Projekte të kërkimit shkencor sipas neneve	Formularët e aplikimit dhe dokumentacion i shoqërues	Përditësohet periodikisht	Vendosur në faqen zyrtare	Drejtoria e Shërbimeve Universitare. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative

	93-96 të ligjit 80/2015;				
Mbajtja e dokumentacionit nga UGJ	Neni 7/1/h të ligjit nr.119/2014, Ligji nr.9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Metodologjia	Tabelë	Me kërkesë të individualizuar	Në faqen zyrtare	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/i të ligjit nr.119/2014,	Kërkesat për informim bëhen sipas formatit tip. Pasqyrohen në regjistrin e kërkesave	Brenda 48 orëve nga miratimi i Programit të Transparencës	Vendosur në faqen zyrtar	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative Koordinatori për të Drejtën e Informimit Yra e Marrëdhënive me publikun.
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k të ligjit nr.119/2014	Vërtetime page nga gjykata ose avokatë, vjetërsi në punë; të dhëna për listimin e kandidatëve	Me kërkesë brenda 10 ditë pune, pas miratimit nga titullari	Me kërkesë	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative Koordinatori për të Drejtën e Informimit Zyra e Marrëdhënive me publikun.

Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1 të ligjit nr.119/2014,	Të dhëna për projektet në të cilat Ugj është angazhuar, studentët e ekselencës dhe studentët e shkëlqyer të Ugj, studenët që përjashtohen/përgjysmohet tarifa e shkollimit, shkollat verore.	Pas miratimit nga organi/titullari përkatë	Vendosur në faqen zyrtare	Spektori I kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Spektori i Shërbimeve Juridike
-----------------------------------	-----------------------------------	--	--	---------------------------	--

II. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, UGj-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit ëëë.uogj.edu.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

III. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa

Shënim

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes. (Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndihmon kërkuuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.